

Eriola Bibolli

Znj. Bibolli është zgjedhur anëtare në Këshillin Drejtues të ProCredit Bank Shqipëri në Mars 2019. Përvoja e saj bankare fillon që nga viti 2001, kur është bërë pjesë e bankës ProCredit në Kosovë. Në vitin 2003 znj. Bibolli u emërua Menaxhere e Menaxhimit të Riskut, ndërsa në vitin 2006 u emërua Drejtoreshë e Financës së ProCredit Bank në Kosovë. Ajo u bë pjesë e Bordit Menaxhues në bankën ProCredit në Kosovë në vitin 2007, dhe në prill të vitit 2008 u emërua Zëvendës Drejtoreshë Ekzekutive. Duke filluar nga muaji Prill 2019 ajo është Drejtoreshë e Përgjithshme e ProCredit Bank në Kosovë.

Znj. Bibolli është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Korçës në Shqipëri, dhe ka përfunduar studimet pasuniversitare me titullin magjistër e menaxhimit të biznesit në Universitetin e Bradford-it në Angli, në bashkëpunim me universitetin Nimbis në Holandë në vitin 2005. Në korrik të vitin 2009, znj. Bibolli përfundoi studimet në Akademinë e Menaxhimit në ProCredit në Furth, Gjermani.

Në të njëjtën kohë, ajo mban përgjegjësi shtesë në kuadër të grupit ProCredit si anëtare në Komitetin e Kontrollit në ProCredit Bank Ukrainë (që nga janari i vitit 2012) dhe si anëtare e Këshillit Drejtues në ProCredit Bank Ekuador (që nga shtatori 2014).